REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 31, datë 29.10.2026

PËR
MIRATIMIN E "RAPORTIT TË "GRANT THORNTON" SHPK
PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM
TË SEKTORIT TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2023 - 31 DHJETOR 2025""

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja "j" dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, të nenit 18, pika 1 dhe pika 4 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 17 të Rregullores "Për kartën e auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", të miratuar me Vendimin Qarkullues të Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 16, datë 30.04.2020, të ndryshuar, si dhe të nenit 18 pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", me propozim të Audituesit të Brendshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e "Raportit të "Grant Thornton" sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, për periudhën 1 janar 2023 - 31 dhjetor 2025"", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj — Kryetar

Shqipe Malaj — Sekretare

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al